



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 28 dhjetor 2021
Nr.ref.:RK 1925/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI176/20

Parashtrues

Flortent Godeni, Fatmir Godeni, dhe Binije Godeni

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, AC.nr.4116/19, të 24 shtatorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Florent Godeni, Fatmir Godeni dhe Binije Godeni, me banim në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë kushtetutshmërinë e Njoftimit [KMLC.nr.145/2020] të 30 tetorit 2020 të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit si dhe Aktvendimin [AC.nr.4116/19] e 24 shtatorit 2020, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), në lidhje me Aktvendimin [PPP.nr.121/2017] e 10 korrikut 2019, të Gjykatës Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara përmes së cilëve parashtruesit e kërkesës pretendojnë të jenë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës Kushtetuese

5. Më 23 nëntor 2020, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 30 nëntor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
7. Më 10 dhjetor 2020, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ata që të dorëzojnë në Gjykatë, Aktvendimin [PPP.nr.121/2017] e 10 korrikut 2019, të Gjykatës Themelore. Të njëjtën ditë Gjykata njoftoi edhe Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 24 dhjetor 2020, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Gjykatë dokumente shtesë lidhur me rastin e tyre, respektivisht Aktvendimin [PPP.nr.121/2017] e 10 korrikut 2019, të Gjykatës Themelore.
9. Më 19 mars 2021, Gjykata kërkoi nga parashtruesit e kërkesës që të dorëzojnë në Gjykatë dy Aktvendime të Gjykatës së Apelit, respektivisht Aktvendimin [Ac.nr.4313/15] e 2 prillit 2017, dhe Aktvendimin [Ac.nr.4315/15] e 3 prillit 2017.

10. Më 29 mars 2021, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Gjykatë dokumentet e kërkuara, respektivisht Aktvendimin [Ac.nr.4313/15] e 2 prillit 2017 dhe Aktvendimin [Ac.nr.4315/15] e 3 prillit 2017 të Gjykatës së Apelit.
11. Më 28 prill 2021, Gjykata kërkoi nga parashtruesit e kërkesës që të plotësojnë formularin e kërkesës.
12. Më 28 prill 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore që të dorëzojë në Gjykatë dosjen e plotë të rastit.
13. Më 14 maj 2021, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan në Gjykatë formularin e kërkesës.
14. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021
15. Më 18 maj 2021, Përmbaruesi Privat, Gjokë Radi dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të rastit.
16. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
17. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
18. Më 8 tetor 2021, Kolegji shqyrtues vendosi që kërkesa të shqyrtohet në një seancë të ardhshme.
19. Më 20 tetor 2021, pasi që dosja e plotë e rastit e dorëzuar në Gjykatë nga Përmbaruesi Privat, Gjokë Radi nuk ishte e plotë, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore, që të dorëzojë në Gjykatë vendimet si në vijim:
 - i) *Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë [E.nr.1062/2013] të 16 shtatorit 2013;*
 - ii) *Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë [E.nr.1063/2013] të 16 shtatorit 2013;*
 - iii) *Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë [CP.1062/2013] të 11 gushtit 2014; si dhe*
 - iv) *Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë [CP.1063/2013] të 11 gushtit 2014*

20. Më 29 tetor 2021, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara.
21. Më 9 dhjetor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe me shumicë i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Përmbledhja e fakteve lidhur me procedurën përmbarimore

22. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesit e kërkesës më 7 korrik 2008, kishin nënshkruar Marrëveshjen mbi kredinë [D-27331] me kreditorin ProCredit Bank, në Gjakovë për kredinë e përgjithshme në vlerë prej 700,000.00 (shtatëqind mijë) euro. Më 2 qershor 2009, parashtruesit e kërkesës kishin nënshkruar edhe një Marrëveshje mbi kredinë me [D-32449] me ProCredit Bank në vlerë prej 350,000.00 (treqind e pesëdhjetë mijë) euro.
23. Më 4 korrik 2008 dhe më 4 qershor 2009, parashtruesit e kërkesës kishin lidhur Marrëveshjet mbi Hipotekën [nr.VR.nr.2387/2008] dhe [VR.nr.2675/2009] me kreditorin ProCredit Bank (në tekstin e mëtejme: Marrëveshjet mbi Hipotekën të lidhura me ProCredit Bank) të cilat ishin vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Gjakovë.
24. Më 7 korrik 2008 dhe më 4 qershor 2009, Zyra Komunale e Kadastrit në Gjakovë, duke vepruar sipas kërkesës së ProCredit Bank, përmes Aktvendimeve me nr. [258/08 dhe 163/09] kishte vendosur hipotekën në pronat për sigurimin e kredisë, e përcaktuar si hipotekë e rendit të parë, të dytë, të tretë dhe të katërt.
25. Më 30 shtator 2010, parashtruesit e kërkesës kishin lidhur Marrëveshjen mbi kredinë me [nr. 1385/2/Gja] me Bankën Ekonomike në vlerë të përgjithshme 233.000,00 (dyqind e tridhjetë e tre mijë) euro. Në të njëjtën datë kishin lidhur edhe Marrëveshjen mbi hipotekën me [nr 1385/3 Gja] (në tekstin e mëtejme Marrëveshja mbi Hipotekën e lidhur me Bankën Ekonomike).
26. Më 18 gusht 2011, ProCredi Bank, u drejtua në Gjykatën Komunale në Gjakovë, me *“Propozim për ekzekutim në palujtshmëri /hipotekë dhe sekuestrim kolarterali”* kundër parashtruesve të kërkesës, bazuar në Marrëveshjet mbi Hipotekën të lidhura me ProCredit Bank.
27. Më 18 gusht 2011, Gjykata Komunale në Gjakovë, përmes [Aktvendimit Ekz.nr.818/11] kishte lejuar përmbarimin në bazë të dokumenteve përmbaruese Marrëveshjeve mbi Hipotekën të lidhura vetëm me ProCredit Bank.
28. Më 11 shtator 2013, Banka Ekonomike kishte paraqitur Propozim për Përmbarim në Gjykatën Themelore, kundër parashtruesve të kërkesës, bazuar në Marrëveshjen mbi Hipotekën të lidhur me Bankën Ekonomike.
29. Më 16 shtator 2013, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimeve [E.nr.1063/2013] dhe [CP.1062/2013] kishte lejuar përmbarimin në bazë të dokumenteve përmbaruese Marrëveshjeve mbi Hipotekën të lidhura me ProCredit Bank.

30. Më 18 tetor 2013, parashtruesit e kërkesës kishin paraqitur prapsim në Gjykatën Themelore, kundër Aktvendimeve të lartpërmendura të Gjykatës Themelore, për lejim të përmbarimit.
31. Më 11 gusht 2014, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [CP.1063/2013] dhe Aktvendimit [CP.1062/2013] kishte refuzuar si të pabazuar prapësimin e parashtruesve të kërkesës.
32. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesit e kërkesës kishin paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktvendimeve të lartpërmendura të Gjykatës Themelore në Gjakovë.
33. Gjykata e Apelit kishte refuzuar ankesën si të pabazuar dhe kishte vërtetuar Aktvendimet e lartpërmendura të Gjykatës Themelore.
34. Më 29 gusht 2014, pas kërkesës së ProCredit Bank, Përmbaruesi Privat, Gjokë Radi, kishte nxjerrë Konkluzionin për shitjen e palujtshmërisë, për përmbushjen e obligimeve kontraktuale, duke caktuar shitjen më 26 shtator 2014 të patundshmërive të lëna në hipotekë.
35. Më 26 shtator 2014, ProCredit Bank përmes parashtresës drejtuar Përmbaruesit Privat, Gjokë Radi, kishte kërkuar që të ndërlihet me procedurën përmbarimore që ishte në zhvillim e sipër me Bankën Ekonomike, ku kjo e fundit kishte iniciuar procedurë përmbarimore në Gjykatën Themelore në Gjakovë, kundër parashtruesve të kërkesës dhe që kishte të bënte me të njëjtat palujtshmëri të lëna në hipotekë. ProCredit Bank ndër të tjera kishte kërkuar që *“mbi bazën e dokumentacionit të prezentuar, që në procedurën e shitjes t’i mundësohet nga kreditori tjetër Banka Ekonomike “si kreditor me të drejtë të siguruar, pas vërtetimit të prioritetit të përmbushjes, të përmbushë borxhin me shitjen e palujtshmërisë lëndore”*.
36. Më 27 janar 2015, Përmbaruesi Privat, Gjokë Radi, përmes Konkluzionit kishte përcaktuar prioritetin e parë për përmbushjen e kërkesës nga palujtshmëria e lënë në hipotekë për kreditorin ProCredit Bank në raport me kreditorin tjetër Bankën Ekonomike.
37. Më 11 shtator 2015, pas mbajtjes së tri seancave publike për shitjen e palujtshmërive të lëna në hipotekë, Përmbaruesi Privat, Gjokë Radi, nga Gjakova kishte nxjerrë Urdhrat Përmbarimorë [E.nr.211/14] dhe [E.nr.210/14] përmes të cilëve si ofertues të vetëm për blerjen e palujtshmërive të lëna në hipotekë, caktoi kreditorin ProCredit Bank. Përmes këtyre dy urdhrave të lartpërmendur ishte përcaktuar si në vijim: i) palujtshmëritë e lëna në hipotekë në bazë të Marrëveshjeve mbi Hipotekën të lidhura me ProCredit Bank, shiten tek kreditori ProCredit Bank; si dhe ii) detyrohen parashtruesit e kërkesës që t’i lirojnë palujtshmëritë e lartpërmendura.
38. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesit e kërkesës kishin paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Urdhrave Përmbarimorë [E.nr.211/14] dhe [E.nr.210/14] duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave përmbarimore,

konstatim të gabuar të gjendjes faktike si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

39. Më 3 prill 2017, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimeve [Ac.nr.4313/2015] dhe [Ac.nr.4315/2015] refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesve të kërkesës dhe kishte vërtetuar Urdhrat Përmbarimor [E.nr.210/14] dhe [E.nr.211/14].
40. Më 25 prill 2017, Përmbaruesi Privat Gjakë Radi, përmes Urdhrave [P.nr.210/14] dhe [P.nr.211/14] konstatoi se palujtshmëritë e parashtruesve të kërkesës, shiten tek kreditori ProCredit Bank.
41. Në një datë të paspecifikuar, ProCredit Bank kishte parashtruar kërkesë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor-Agjencinë Kadastrale të Kosovës, që në bazë të Urdhërit të Përmbaruesit Privat Gjakë Radi [P.nr.211/14] i 26 tetorit 2015 dhe [P.nr.210/2014] i 26 tetorit 2015, të bëhet bartja e pronave nga parashtruesit tek ProCredit Bank.
42. Më 15 qershor 2017, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor-Agjencia Kadastrale e Kosovës, Përmes Aktvendimeve [nr.937/2017] dhe [nr.938/2017] vendosi që kërkesa e ProCredit Bank të miratohet në funksion të zbatimit të Urdhrave të lartcekur.
43. Më 7 gusht 2017, Përmbaruesi Privat Gjakë Radi, përmes Konkluzionit [P.nr.189/17] njoftoj parashtruesit e kërkesës që më së largu deri më 30 gusht 2017, t'i lirojnë të gjitha pronat në posedim dhe shfrytëzim tek kreditori ProCredit Bank, në të kundërtën përmbarimi i kërkesës do bëhet në mënyrë të dhunshme.

Përmbledhja e fakteve lidhur procedurat për parregullsi procedurale në procedurën përmbarimore

44. Më 23 gusht 2017, parashtruesit e kërkesës kishin parashtruar ankesë në Gjykatën Themelore, duke pretenduar se kishin ndodhur parregullsi procedurale të zhvilluara në procedurën përmbarimore nga Përmbaruesi Privat, Gjakë Radi, nga Gjakova duke pretenduar ndër të tjera se ishin duke u zhvilluar dy procedura paralele për njërën nga palujtshmëritë e lëna në hipotekë, dhe që ka të bëjë me vërtetimin e pronësisë nga palët e treta, duke shtuar se në procedurën përmbarimore të zhvilluar lidhur me rastin konkret, janë të përfshira palët që nuk kanë qenë palë në procedurë. Ndër të tjera, parashtruesit e kërkesës propozuan që të shtyhet edhe shitja e palujtshmërive sipas Konkluzionit të Përmbaruesit Privat.
45. Në të njëjtën ditë, parashtruesit e kërkesës përmes parashtresës drejtuar Përmbaruesit privat Gjakë Radi, kërkuan që të shtyhet ekzekutimi i përmbarimit të dhunshëm në bazë të Konkluzionit [P.nr.189/17], duke theksuar se kishin parashtruar ankesë në Gjykatën Themelore, për parregullsitë procedurale të zhvilluara në procedurën përmbarimore dhe më tej pretenduan se atyre do ju shkactohej dëm i jashtëzakonshëm material në rast se nuk miratohet kërkesa e tyre.

46. Më 30 gusht 2017, parashtruesit e kërkesës kishin parashtruar kërkesë në Gjykatën Themelore, për përjashtimin e Përmbaruesit Privat, Gjokë Radi, nga Gjakova me pretendimin se *“Gjatë ushtrimit të detyrës së të njëjtit si gjyqtar përmbarues pranë Gjykatës Themelore të Gjakovës, po tani përmbarues privat janë ndërmarrë një sërë veprimesh ligjore duke marrë edhe vendime kur kjo çështje ishte për vendosje dhe shqyrtim pranë Titullarit. Përmbaruesi Privat Gjokë Radi i ka të qarta dhe tejet të kristalizuara të metat procedurale, por çuditërisht në mungesë të objektivitetit të tij i njëjti i anashkalon këto të meta edhe pse kjo rrethanë i është njohur”*.
47. Më 31 gusht 2017, Përmbaruesi Privat, Gjokë Radi, përmes deklaratës drejtuar Gjykatës Themelore në Gjakovë kishte kundërshtuar kërkesën e parashtruesve për përjashtimin e tij, nga procedura duke arsyetuar se *“Me urdhrin P.nr.210/14 të dt. 26.10.2015 dhe me Urdhrin P.nr.211/14 të dt 26.10.2015 ka përfunduar procedura me shitjen e palujtshmërive të debitorëve”*.
48. Më 7 gusht 2018, Përmbaruesi Privat, Gjokë Radi, përmes Konkluzionit (P.nr.189/17), kishte kërkuar që parashtruesit e kërkesës të lirojnë të gjitha palujtshmëritë e lëna në hipotekë.
49. Më 10 korrik 2019, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [PPP.nr.121/17] refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesve të kërkesës, ndërsa kërkesën specifike të parashtruesve të kërkesës për përjashtimin e Përmbaruesit Privat, Gjokë Radi, nga Gjakova e hodhi poshtë. Në Aktvendim tutje shtohet se *“përmbaruesi privat ka vepruar konform dispozitave ligjore të ligjit të procedurës përmbarimore vazhduar procedurën përmbarimore të LPP-së, po ashtu lidhur me pretendimet e debitorëve se janë duke u zhvilluar dy procedura paralele nuk qëndron një fakt i tillë pasi që procedura përmbarimore është procedurë tjetër krahas procedurës civile dhe se në rast suksesi në procedurën civile debitorët kanë të drejtë të kërkojnë kundër përmbarimit sipas nenit 54 te LPP-së. [...] Gjykata në punën e përmbaruesit privat Gjokë Radi, nuk ka vërejtur asnjë parregullsi siç pretendohet nga debitorët sepse te gjitha pretendimet e sipërcituara të debitorit në fjalë kanë qenë objekt shqyrtimi dhe janë konsumuar edhe me ankesat e debitorëve janë refuzuar si te pa bazuar duke e vërtetuar sipas aktvendimeve te Gjykatës se Apelit te Kosovës AC.nr.4313/15 te dt.03.04.2017 dhe aktvendimin Ac.nr4315/15 të dt.03.04.20 [...]”*.
50. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar aplikim të gabuar të së drejtës materiale dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike.
51. Më 24 shtator 2020, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [Ac.nr.4116/19], refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesve të kërkesës dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore [PPP.nr.121/2017] duke e konsideruar të njëjtin si të drejtë dhe të ligjshëm. Lidhur me pretendimin e parashtruesve se Gjykata Themelore gabimisht kishte aplikuar dispozitën e nenit 67 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, Gjykata e Apelit kishte theksuar se bazuar në dispozitën e lartcekur *“ kjo ka të bëjë me rastet kur gjykatësi ka vendosur në shkallë të pare ndërsa merr pjesë në vendosje në shkallë të dytë apo e kundërta”*.

Për më tepër Gjykata e Apelit lidhur me këtë pretendim shton se sipas nenit 68.4 të LPK-së i cili në këtë rast aplikohet përshtatshmërisht, parashtruesit e kërkesës në cilësi të debitorit, kanë obligim që t'i cekin arsyet që kërkojnë përjashtimin, e në rastin konkret nuk e kanë bërë.

52. Më 19 tetor 2020, parashtruesit e kërkesës iu drejtuan Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, kundër Aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.
53. Më 30 tetor 2020, Zyra e Prokurorit të Shtetit, përmes Njoftimit KMLC.nr.145/2020, njoftoi parashtruesit e kërkesës se pretendimet e tyre nuk janë të mjaftueshme për të paraqitur kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

54. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me aktvendimet e kontestuara u janë shkelur të drejtat e garantuar me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ.
55. Fillimisht parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *“për shkak të parregullsive gjatë kryerjes së përmbarimit tek përmbaruesi Gjokë Radi. nga Gjakova, kanë ndërmarrë veprimet e lejueshme ligjore pas lejimit të propozimit për përmbarim të ky përmbarues në lëndën P.nr.179/2017 ndaj të cilit përmbarues për shkak të parregullsive gjatë zbatimit të procedurës përmbarimore e që debitorët kanë kërkuar diskualifikimin e tij”*.
56. Parashtruesit e kërkesës para Gjykatës ankohen se gjatë kryerjes së procedurave përmbarimore lidhur me rastin e tyre tek Përmbaruesi Privat, Gjokë Radi, ka pasur parregullsi të shumta. Lidhur me këtë, parashtruesit pretendojnë se *“Për shkak të veprimeve tërësisht kundërligjore dhe kundër kushtetuese të përmbaruesit Gjokë Radi, nga Gjakova, e të cilat bijnë ndesh edhe me dokumentin e besueshëm në bazë të së cilit ky përmbarues ka lejuar edhe propozimin për ekzekutim të kreditorit ProCredit Bank, me seli në Prishtinë. Propozuesi i përmbarimit ProCredit Bank, duke shfrytëzuar pozitën e saj si kredidhënës ka ndërmarrë asi veprime të cilat ky përmbarues i ka trajtuar si të vërteta edhe pse ato veprime bien ndesh me dispozitat ligjore pozitive. Organi përmbarues pa u lëshuar në dispozitat ligjore përkatësisht të LPP ka bërë lejin e propozimit për ekzekutim edhe pse nuk do duhej të bënte”*.
57. Parashtruesit para Gjykatës pretendojnë se vendimet e kontestuara nuk janë mjaftueshëm të arsyetuara duke theksuar: *“Gjykata e shkallës së parë me të cilën ka refuzuar ankesën e debitorëve për përjashtim të përmbaruesit me Aktvendimin në saj PPP.nr.121/2017 ka dhënë arsye të mangëta dhe jo thelbësore duke mos arsyetuar aktvendimin e sajë me asnjë dispozite ligjore.”* Parashtruesit tutje theksojnë: *“sa i përket Aktvendimit të Gjykatës së Apelit si dhe njoftimit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit Lidhur me Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të ushtruar nga debitorët nuk janë fare në arsyet ankimore në të cilin Aktvendim përkatësisht Njoftim në arsyet e tyre kanë konstatuar shkurtimisht se Aktvendimi i Gjykatës së shkallës së parë vërtetohet*

përkatësisht me njoftim thotë se nuk janë plotësuar kushtet e që është një absurditet”.

58. Sa i përket Aktvendimit të Gjykatës së Apelit dhe Njoftimit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, parashtruesit e kërkesës theksojnë se *“Gjykatat e rregullta kanë shkelur parimin e ligjshmërisë dhe drejtëshmërisë. Andaj konsiderojmë që Aktvendimet e atakuara me këtë ankese janë përfshirë me shkelje të të drejtave kushtetuese përkatësisht me këtë rast ankuesve i janë shkelur të drejtat elementare njerëzore dhe atë e drejta e mbrojtur e parapare me nenin 6 të Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe nenit 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në kuadër të cilës të dëmtuarve i është shkelur e drejta në gjykim në drejtë dhe në barabarësi të palëve në procedurë dhe drejta sipas nenit 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në mbrojtje Gjyqësore e të Drejtave”.*
59. Parashtruesit e kërkesës tutje përmes plotësimit të kërkesës pretendojnë se gjatë gjithë procedurës përmbarimore *“përkundër kërkesës sonë dhe iniciativës që të bëhet ekspertiza financiare si dhe e ndërtimtarisë për caktimin e vlerës së tregut për paluejtshmëritë e lëna në hipotekë, është kundërshtuar nga përfaqësuesi i kreditorit dhe i aprovuar nga përmbaruesi privat me arsyetimin se propozimi për caktimin e ekspertit të financave dhe i ndërtimtarisë ka për qëllim dhe i shërben vetëm zvarritjes së procedurë”.*
60. Parashtruesit në fund kërkojnë nga Gjykata që të anulojë: i) Aktvendimin [AC.nr.4116/19] e 24 shtatorit 2020 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktvendimin [PPP.nr.121/2017] e 10 korrikut 2019, të Gjykatës Themelore; si dhe ii) Njoftimin KMLC.nr.145/2020 të 30 tetorit 2020 të Zyrës së Kryeprokurorit të shtetit.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

[....]

Ligji Nr.03/Lo06 për Procedurën Kontestimore

Neni 67

Gjyqtari nuk mund ta procedojë çështjen juridike:

a) në qoftë se është vetë palë, përfaqësues ligjor apo me prokurë i palës, apo në qoftë se me palën është bashkëkreditor apo bashkëdebitor ose i obliguar

për regresim, apo në qoftë se në të njëjtën çështje është dëgjuar si dëshmitar ose si ekspert;

b) në qoftë se pala ose përfaqësuesi ligjor apo me prokurë i saj është kushëri gjaku në vijën vertikale deri në cilëndo shkallë, kurse në vijën horizontale deri në shkallë të katërt, apo në qoftë se është bashkëshort, apo gjini e krushqisë deri në shkallë të dytë, pavarësisht nëse martesë ka pushuar ose jo;

c) në qoftë se është kujdestar, adoptues ose i adoptuar i palës, i përfaqësuesit të saj ligjor ose me prokurë;

d) në qoftë se në të njëjtën çështje ka marrë pjesë në dhënien e vendimit të gjykatës më të ulët, ose te organit tjetër, ose në procedurën e ndërmjetësimit;

e) në qoftë se ka vepruar në çështjen në të cilën është bërë ujdia gjyqësore, e me padinë e ngritur kërkohet anulimi i ujdisë së këtillë;

f) në qoftë se është aksionar apo anëtar i shoqërisë tregtare që është palë në procedurën e iniciuar me padi;

g) në qoftë se ekzistojnë rrethana të tjera që e vejnë në dyshim paanësinë e tij.

Neni 68

[...]

68.4 Pala ka për detyrë që në kërkesën për përjashtim t'i cekë rrethanat nga të cilat përfundon se ekziston ndonjë bazë ligjore për përjashtimin e gjyqtarit.

Neni 247

247.1 Prokurori publik mund ta ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë:

a) për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, në qoftë se shkelja ka të bëjë me kompetencën territoriale, po qe se gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë aktgjykimin pa seancë kryesore, kurse e ka pasur detyrë ta mbajë seancën kryesore, po qe se është vendosur për kërkesën, rreth së cilës kontestimi është në vazhdim, apo në qoftë se në kundërshtim me ligjin, është përjashtuar publiku në seancën kryesore;

b) për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

61. Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
62. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

63. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.”

64. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar; kontestojnë akte të autoriteteve publike, përkatësisht Njoftimin [KMLC.nr.145/2020] të 30 tetorit 2020 të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit si dhe Aktvendimin [AC.nr.4116/19] të 24 shtatorit 2020 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktvendimin [PPP.nr.121/2017] e 10 korrikut 2019, të Gjykatës Themelore pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike.

Parashtruesit e kërkesës kanë saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendojnë se u janë shkelur, si dhe, e kanë dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.

65. Përveç këtyre kriterëve, Gjykata po ashtu i referohet rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

66. Gjykata, fillimisht thekson që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
67. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *“qartazi e pabazuar”* në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si *“pretendime qartazi të pabazuara”*. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*; dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuze dhe të paqarta”*.
68. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesve të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
69. Rastit në fjalë ndërlidhet me dy kredi të cilat parashtruesit i kishin lidhur në vitin 2008 dhe 2009 me Pro Credit Bank si dhe në vitin 2010 edhe me Bankën Ekonomike. Si rezultat i mos pagesës së plotë të borxhit të kredisë, për realizimin e plotë të borxhit në bazë të Kontratave mbi Hipotekën, Banka Ekonomike kishte paraqitur në Gjykatën Themelore, propozim për përmbarim të cilën Gjykata Themelore e kishte aprovuar duke lejuar përmbarimin. Pas prapësimit të parashtruesve të kërkesës kundër Aktvendimeve për lejim të përmbarimit, Gjykata Themelore kishte refuzuar prapësimin. Më pas parashtruesit e kërkesës kishin paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, dhe kjo e fundit kishte refuzuar ankesat. Pas mbajtjes së tri seancave publike për shitjen e palujtshmërive të lëna në hipotekë, Përmbaruesi Privat, Gjokë Radi, kishte nxjerrë dy Urdhra

Përmbarimorë, përmes të cilave caktoi ProCredit Bank si ofertues të vetëm për blerjen e patundshmërive të lëna në hipotekë. Më pas, parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit kundër dy Urdhrave Përmbarimorë, dhe kjo e fundit refuzoi si të pabazuar ankesat e parashtruesve. Më tutje, parashtruesit e kërkesës kishin parashtruar ankesë në Gjykatën Themelore, duke pretenduar se kishin ndodhur parregullsi procedurale të zhvilluara në procedurën përmbarimore, nga Përmbaruesi Privat, Gjokë Radi, si dhe kërkuar përjashtimin e Përmbaruesit Privat, Gjokë Radi, nga rasti i tyre. Gjykata Themelore refuzoi ankesat e parashtruesve të kërkesës. Aktvendimi i Gjykatës Themelore u vërtetua edhe nga Gjykata e Apelit. Pas parashtrimit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, Zyra e Prokurorit të Shtetit, njoftoi parashtruesit e kërkesës se pretendimet e tyre nuk janë të mjaftueshme për të ngritur kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

70. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendimet për shkeljen e të drejtave të tyre i ndërlidhin duke u thirrur në shkeljen e neneve 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës, duke theksuar se *“te dëmtuarve i është shkelur e drejta në gjykim të drejtë dhe në barabarësi të palëve në procedurë dhe drejta sipas nenit 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në mbrojtje Gjyqësore e të Drejtave”*.
71. Parashtruesit e kërkesës në ndërlidhje me pretendimet e tyre për shkeljen e neneve 32 dhe 54, vetëm kane përmendur shkeljen e neneve të Kushtetutës, duke mos ofruar asnjë arsytim dhe duke mos mbështetur pretendimet e tyre rreth mënyrës se si vendimin i kontestuar, përfshirë edhe vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët, mund të kenë rezultuar në shkeljen e këtyre të fundit.
72. Lidhur me pretendimet e parashtruesve për shkeljen e nenit 32 dhe 54 të Kushtetutës, Gjykata thekson se fakti i thjeshtë se parashtruesit e kërkesës nuk janë të kënaqur me rezultatin e Aktvendimit të Gjykatës Apelit apo vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33)
73. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës ankohen për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sipas nenit 6 të KEDNJ-së, e cila ndërlidhet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
74. Gjykata vëren se, në substancë, parashtruesit e kërkesës ankohen se deri tek shkelja e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, ka ardhur me: i) veprimet kundërligjore dhe kundër kushtetuese të përmbaruesit privat të cilat bien ndesh me: 1. Dokumentin e besueshëm në bazë të cilit përmbaruesi ka lejuar propozimin për ekzekutim të kreditorit ProCredit Bank; 2. Përmbaruesi i ka trajtuar si të vërteta veprimet e ProCredit Bank edhe pse ato veprime bien ndesh me dispozitat ligjore pozitive; dhe 3. Organi përmbarues, pa u lëshuar ne dispozita ligjore përkatësisht LPPP ka bërë lejimin e propozimit për ekzekutim edhe pse nuk do të duhej të bënte; si dhe ii) se vendimet e instancave më të ulëta nuk janë të arsyetuara duke pretenduar si në

vijim “Gjykata e shkallës së parë me të cilën ka refuzuar ankesën e debitorëve për përjashtim të përmbaruesit me Aktvendimin ne saj PPP.nr.121/2017 ka dhënë arsye të mangëta dhe jo thelbësore duke mos arsyetuar aktvendimin ne saje me asnjë dispozite ligjore [...] sa i përket Aktvendimit të Gjykatës së Apelit si dhe njoftimit të Zyrës së Kryeprokurorit te Shtetit Lidhur me Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të ushtruar nga debitorët nuk janë fare në arsyet ankimore në të cilin Aktvendim përkatësisht Njoftim në arsyet e tyre kane konstatuar shkurtimisht se Aktvendimi i Gjykatës së shkallës së parë vërtetohet përkatësisht me njoftim thotë se nuk janë plotësuar kushtet e që është një absurditet”.

Lidhur me pretendimet e lartcekura, Gjykata vëren se të njëjtat pretendime parashtruesit e kërkesës i kanë ngritur edhe pranë gjykatave të rregullta.

Përkitazi me pretendimin për mungesën e arsytimit të vendimeve gjyqësore

75. Së pari, Gjykata rikujton pretendimet e parashtruesve të kërkesës në ndërlidhje me këtë pretendim, ku theksojnë se: “Gjykata e shkallës së parë me të cilën ka refuzuar ankesën e debitorëve për përjashtim të përmbaruesit me Aktvendimin ne saj PPP.nr.121/2017 ka dhënë arsye të mangëta dhe jo thelbësore duke mos arsyetuar aktvendimin e saj me asnjë dispozite ligjore.”
76. Gjykata nga kërkesa e parashtruesve të kërkesës nuk vëren se parashtruesit në ndërlidhje me këtë pretendim e kanë si pretendim specifik para Gjykatës paanshmërinë e përmbaruesit Privat Gjokë Radi, për rolin e tij të dyfishtë, si gjyqtar që e kishte lejuar përmbarimin dhe në fazë të mëvonshme kishte vepruar edhe si Përmbarues Privat.
77. Parashtruesit tutje theksojnë: “sa i përket Aktvendimit të Gjykatës së Apelit si dhe njoftimit të Zyrës së Kryeprokurorit te Shtetit Lidhur me Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të ushtruar nga debitorët nuk janë fare në arsyet ankimore në të cilin Aktvendim përkatësisht Njoftim në arsyet e tyre kane konstatuar shkurtimisht se Aktvendimi i Gjykatës së shkallës së parë vërtetohet përkatësisht me njoftim thotë se nuk janë plotësuar kushtet e që është një absurditet”.
78. Fillimisht, Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ, e cila ka vlerësuar se, edhe pse autoritetet gëzojnë liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme për të siguruar që sistemet e tyre gjyqësore të jenë në përputhje me kërkesat e nenit 6.1 të KEDNJ, gjykatat e tyre duhet “të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ata bazuan vendimin e tyre” (shih *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, kërkesa nr. 12945/87, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues “IKK Classic”, Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 45; shih rastin KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 majit 2018, paragrafi 54).
79. Në përputhje me praktikën e GJEDNJ, edhe kjo Gjykatë, në një mori rastesh, ka theksuar se megjithëse gjykatat nuk janë të detyruara të adresojnë të gjitha pretendimet e parashtruara nga parashtruesit, gjykatat kanë për obligim të adresojnë pretendimet qendrore për rastet para tyre (shih, *mutatis mutandis*,

rastin e sipërcekur të Gjykatës KI97/16, parashtrues “IKK Classic”, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 53). Në këtë aspekt, e drejta për të marrë një vendim gjyqësor në pajtim me ligjin përfshin detyrimin që gjykatat të japin arsyet për vendimet e tyre, si në nivelin procedural ashtu edhe në atë material (shih, *mutatis mutandis*, rastin e sipërcekur të Gjykatës KI97/16, parashtrues “IKK Classic”, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 54).

80. Në rastin e parashtruesve të kërkesës, Gjykata fillimisht rikujton se përmes Njoftimit [KMLC.nr.145/2020] të Zyrës së Prokurorit të Shtetit njoftoi parashtruesit e kërkesës se pretendimet e tyre nuk janë të mjaftueshme për të paraqitur kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, siç është e përcaktuar në nenin 247.1 pika a dhe b të Ligjit për Procedurën Kontestimore.
81. Andaj në dritën e asaj që u tha më lart, Gjykata vlerëson se përmes Njoftimit të KMLC.nr.145/2020 të Zyrës së Prokurorit të Shtetit nuk janë trajtuar meritat e rastit të parashtruesve të kërkesës.
82. Më tutje, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës së Apelit në Aktvendimin [Ac.nr.4116/19] e 24 shtator 2020 i cili kishte trajtuar në merita kërkesën e parashtruesve, dhe përmes së cilit kishte refuzuar si të pathemeltë ankesën e parashtruesve të kërkesës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, duke theksuar si në vijim:

“Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorëve se aktvendimi i ankimuar është i kundërligjshëm, sepse sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të ankimuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin [...] sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë nuk e ka aplikuar gabimisht dispozitën nga neni 67 par 1 pikad) dhe g) të LPK-së, kjo për faktin se me nenin 67 par 1, pika d, përcaktohet Gjyqtari nuk mund të procedojë çështjen juridike; d) në qoftë se në të njëjtën çështje ka marrë pjesë në dhënien e vendimit të gjykatës më të ulët, ose te organit tjetër, ose në procedurën e ndërmjetësimit. Pra nga kjo dispozitë shihet qartë se nuk mund të bëhet fjalë për përjashtim, për faktin se kjo ka të bëjë në rastet kur gjykatësi ka vendosur në shkallë të parë, ndërsa merr pjesë në vendosje në shkallë të dytë, apo e kundërta. Ndërsa sa i përket nenit 67 par 1 pika g) i cili në kuptim të nenit 325 par 2 të LPP-së aplikohet përshtatshëmrisht (mutatis mutandis) edhe për përmbaruesin privat, në kuptim të nenit 68.4 të LPP-së debitori ka për detyrë që në kërkesën për përjashtimin të cekë rrethanat nga të cilat mendon se ekziston ndonjë bazë ligjore për përjashtimin e tij, të cilën gjë debitorët nuk e kanë bërë, por vetëm në mënyrë të përgjithësuar kanë pretenduar se përmbaruesit privat i mungon objektiviteti i tij.”

83. Përveç kësaj, Gjykata po ashtu i referohet edhe Aktvendimit [PPP.nr.121/17] të Gjykatës Themelore, të 10 korrikut 2019, i cili vendim ndërlidhet me procedurën e dytë të iniciuar më 23 gusht 2017, nga parashtruesit e kërkesës, të cilët përmes ankesës kishin pretenduar se kishin ndodhur parregullsi procedurale në procedurën përmbarimore. Aktvendimi i lartpërmendur lidhur me pretendimet e parashtruesve të kërkesës thekson si në vijim: “Përmbaruesi privat ka vepruar konform dispozitave ligjore të ligjit të procedurës përmbarimore vazhduar

procedurën përmbartimore të LPP-së, po ashtu lidhur me pretendimet e debitorëve se janë duke u zhvilluar dy procedura paralele nuk qëndron një fakt i tillë pasi që procedura përmbartimore është procedure tjetër krahas procedurës civile dhe se ne rast suksesi ne procedurën civile debitorët kanë të drejtë të kërkojnë kundër përmbartimit sipas nenit 54 të LPP-së. [...] Gjykata në punën e përmbartuesit privat Gjokë Radi, nuk ka vërejtur asnjë parregullsi siç pretendohet nga debitorët sepse të gjitha pretendimet e sipërcituara të debitorit në fjalë kanë qenë objekt shqyrtimi dhe janë konsumuar edhe me ankesat e debitorëve janë refuzuar si të pa bazuar duke e vërtetuar sipas aktvendimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës AC.nr.4313/15 të dt.03.04.2017 dhe aktvendimin Ac.nr.4315/15 të dt.03.04.2017 [...] Pretendimi nga kërkesa e debitorëve që i referohet motivimit se do të jetë i anshëm, e mbështetur në nenin 67 par 1 nën par g) dhe d) të LPK-së, ka të bëjë me atë që përmbartuesi privat mund të përjashtohet nëse ekzistojnë rrethanat të tjera që e vejnë në dyshim paanësinë e tij në vendosje, ndërsa në rastin konkret nuk mund të bëhet fjalë për përjashtim sipas nenit 67 pika d) për faktin se ajo ka të bëjë në rast kur Gjykata ka vendosur në shkallë të parë, ndërsa ka marrë pjesë në vendosje edhe në shkallë të dytë apo e kundërta, ndërsa pretendimet tjera se nuk i janë dhënë shkresat nuk hyjnë në shkaqet e përjashtimit. Në nenin 67 par 1 nën par g) të LPK, i cili në kuptim të nenit 325 par 2. Të LPP, aplikohet përshtatshmërisht (mutatis mutandis) edhe për përmbartuesin privat, në kuptim të nenit 68.4 të LPP-së debitori-përfaqësuesi i përkohshëm ka pasur për detyrë që në kërkesën për përjashtim t'i cekë rrethanat nga të cilat përfundon se ekziston ndonjë bazë ligjore për përjashtimin e tij, këtë nuk e ka bërë në mënyrë specifike por vetëm në mënyrë të përgjithësuar ka pretenduar se i mungon objektiviteti i tij)

84. Nën dritën e asaj që u tha më lart, Gjykata arrin në përfundimin se Aktvendimi [Ac.nr.4116/19] i 24 shtatorit 2020, i Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimi i Gjykatës Themelore, janë të qartë dhe adresojnë pretendimet thelbësore të ngritura nga parashtruesit e kërkesës. Nuk ka ndonjë argument thelbësor të cilin gjykatat e rregullta e kanë lënë mënjanë si të paarsyetuar, siç pretendojnë parashtruesit e kërkesës.
85. Rrjedhimisht, Gjykata e Apeli ka arritur në këtë përfundim pasi që e ka shqyrtuar arsyetimin e dhënë nga Gjykata Themelore.
86. Prandaj, Gjykata konsideron se përfundimet e gjykatave të rregullta janë arritur pas një shqyrtimi të hollësishëm të të gjitha argumenteve të parashtruara nga parashtruesit e kërkesës. Si rrjedhojë, Gjykata vlerëson se arsyetimi i dhënë nga Gjykata e Apelit i plotëson të gjitha standardet e nevojshme të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës për një vendim gjyqësor të arsyetuar.
87. Në rastin e parashtruesve të kërkesës Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesve të kërkesës të ngritura në Gjykatë, kryesisht ngrisin çështje të ligjshmërisë.
88. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).

Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në përputhje me praktikën e GJEDNJ dhe po ashtu edhe me praktikën e saj tanimë të konsoliduar, Gjykata rithekson se është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të ligjit procedural dhe material dhe se nuk mund të bëhen vlerësime abstrakte se pse një gjykatë e rregullt ka vendosur në një mënyrë të caktuar e jo në një tjetër (shih rastin *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, par. 28 dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

89. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse në një proces provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të atillë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, ndër autoritete të tjera, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr.13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).
90. Në dritën e kësaj, Gjykata më tej konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar se procedurat në Gjykatën e Apelit apo në gjykatat e tjera të rregullta kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tyre të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të së drejtës procedurale. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë (shih rastin e Gjykatës KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44 dhe shih, gjithashtu rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjokaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).
91. Gjykata thekson se fakti i thjeshtë se parashtruesit e kërkesës nuk janë të kënaqur me rezultatin e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit apo vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
92. Si rezultat, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk i kanë mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe që me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.

Përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se nuk është marrë parasysh nga gjykatat e rregullta kërkesa e parashtruesve për ekspertizë financiare të ngritur nga parashtruesit e kërkesës, pas kërkesës së kësaj të fundit të datës 28 prill 2021, për plotësim të formularit

93. Lidhur me këtë pretendim të parashtruesve të kërkesës dhe që ka të bëjë me mostrajtmin nga ana e gjykatave e rregullta të kërkesës së parashtruesve për ekspertizë financiare, lidhur me vlerësimin e vlerës së patundshmërive, Gjykata rikujton se ky pretendim në Gjykatë u ngrit nga parashtruesit e kërkesës, pas kërkesës së kësaj të fundit të datës 28 prill 2021, për plotësim të formularit.
94. Gjykata e rikujton edhe një herë pretendimin e lartcekur që parashtruesit e ngrisin në Gjykatë, duke arsyetuar si në vijim *“përkundër kërkesës sonë dhe iniciativës që të bëhet ekspertiza financiare si dhe e ndërtimtarisë për caktimin e vlerës së tregut për paluejtshmëritë e lëna në hipotekë, është kundërshtuar nga përfaqësuesi i kreditorit dhe i aprovuar nga përmbaruesi privat me arsyetimin se propozimi për caktimin e ekspertit të financave dhe i ndërtimtarisë ka për qëllim dhe i shërben vetëm zvarritjes së procedurës”*.
95. Gjykata vëren se këtë pretendim parashtruesit e kërkesës e kanë ngritur për herë të parë vetëm pas kërkesës së Gjykatës për plotësim të formularit, pretendim ky i cili nuk është ngritur në kërkesën fillestare të parashtruesve, dhe as në plotësimet e mëvonshme të kërkesës me dokumentacion shtesë.
96. Gjykata vëren se këtë pretendim parashtruesit e kërkesës përveç që e kanë përmendur si fakt, nuk e kanë elaboruar më tutje se si ky fakt ka rezultuar në shkelje kushtetuese.
97. Gjykata, bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, vlerëson se pretendimet e parashtruesve të kërkesës janë pretendime *“të pambështetura apo paarsyetuara”*. Kjo sepse, parashtruesit e kërkesës vetëm kanë përmendur shkeljen e neneve të Kushtetutës, duke mos ofruar asnjë arsyetim dhe duke mos mbështetur pretendimet e tyre rreth mënyrës së si Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, përfshirë edhe vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët, mund të kenë rezultuar në shkeljen e të drejtat dhe lirive themelore të tyre të garantuara me Kushtetutë.
98. Gjykata gjithashtu rikujton se ajo vazhdimisht ka theksuar se vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsyetim të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar makinerinë e mbrojtjes që ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. (Shih, në këtë kontest, rastet e Gjykatës K102/18, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafin 36; dhe K195/19, parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31; shih, gjithashtu, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 4. Ankesat e paarsyetuara: mungesa e provave, paragrafët 280 deri më 283).

99. Gjykata, gjithashtu rikujton se, duke u bazuar në nenin 48 të Ligjit dhe paragrafët (1) (d) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe praktikën e saj gjyqësore, ajo vazhdimisht ka theksuar se (i) palët kanë detyrim që të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqesin faktet dhe pretendimet; dhe gjithashtu (ii) të dëshmojnë dhe në mënyrë të mjaftueshme të mbështesin pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.
100. Prandaj, Gjykata konstaton se ky pretendim i parashtruesve të kërkesës, është pretendim *“të pambështetura apo paarsyetuara”*, dhe rrjedhimisht, të papranueshme si qartazi të pabazuara në bazë kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës

Përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për veprimet kundërligjore dhe kundër kushtetuese të Përmbauesit Privat

101. Përkitazi me këtë pretendim Gjykata vlerëson se në rrethanat e rastit konkret, si çështje paraprake, duhet të vlerësojë: nëse (i) ky pretendim i parashtruesve të kërkesës është dorëzuar brenda afatit ligjor katër (4) muor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës; dhe (ii) cili është *“vendimi i fundit”* në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës në ndërlidhje me rrjedhjen e afatit ligjor katër (4) muor nga neni 49 i Ligjit në lidhje me këtë pretendim specifik.
102. Në ndërlidhje me këtë pretendim, Gjykata fillimisht rikujton pretendimin e parashtruesve të kërkesës të cilët theksojnë se: *“Për shkak te veprimeve tërësisht kundërligjore dhe kundër kushtetuese të përmbauesit Gjokë Radi, nga Gjakova, e të cilat bijnë ndesh edhe me dokumentin e besueshëm në bazë të së cilit ky përmbaues ka lejuar edhe propozimin për ekzekutim të kreditorit ProCredit Bank, me seli në Prishtinë. Propozuesi i përmbaimit ProCredit Bank, duke shfrytëzuar pozitën e saj si kredidhënës ka ndërmarrë asi veprime te cilat ky përmbaues i ka trajtuar si te vërteta edhe pse ato veprime bien ndesh me dispozitat ligjore pozitive. Organi përmbaues pa u lëshuar ne dispozitat ligjore përkatësisht të LPP ka bërë lejin e propozimit për ekzekutim edhe pse nuk do duhej të bënte”*.
103. Parashtruesit e kërkesës në thelb para Gjykatës ngrisin të njëjtat pretendime që i kishin ngritur në Gjykatë Themelore në Gjakovë ku kishin theksuar se kishin ndodhur parregullsi procedurale të zhvilluara në procedurën përmbaimore (shih paragrafët 21-42 më lartë) nga Përmbauesi Privat, Gjokë Radi, nga Gjakova sepse sipas tyre ishin duke u zhvilluar dy procedura paralele për njërën nga palujtshmëritë e lëna në hipotekë, dhe që ka të bëjë me vërtetimin e pronësisë nga palët e treta, duke shtuar se në këtë procedurë janë të përfshira palët që nuk kanë qenë palë në procedurë. Gjykata rikujton se ne procedurën përmbaimore më 3 prill 2017, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimeve [Ac.nr.4313/2015] dhe [Ac.nr.4315/2015] refuzoi si të pabazuara ankesën e parashtruesve të kërkesës [kundër urdhrave përmbaimore për shkak te parregullsive] dhe kishte vërtetuar Urdhrrat Përmbaimore [E.nr.210/14] dhe [E.nr.211/14].

104. Gjykata vëren se në procedurën përmbartimore vendimet e fundit janë, Aktvendimet [Ac.nr.4313/2015] dhe [Ac.nr.4315/2015] të 3 prillit 2017, të Gjykatës së Apelit me të cilët ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa e parashtruesve të kërkesës dhe ishin vërtetuar Urdhrat Përmbartimorë [E.nr.210/14] dhe [E.nr.211/14], vendime këto që ndërlidhen me procedurën përmbartimore e cila kishte përfunduar në vitin 2017
105. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Aktvendimi [Ac.nr.4313/2015] i Gjykatës së Apelit, i 3 prillit 2017 dhe Aktvendimi [Ac.nr.4315/2015] i Gjykatës së Apelit i 3 prillit 2017, janë: “vendimi i fundit” në rastin e parashtruesit të kërkesës, lidhur me pretendimin e tyre specifik lidhur me parregullsitë procedurale të zhvilluara tek përmbartuesi privat.
106. Gjykata më tutje rikujton se kërkesa e parashtruesve të kërkesës është dorëzuar në Gjykatë më 23 nëntor 2020, respektivisht kërkesa është dorëzuar pas afatit ligjor katër (4) muajor.
107. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej katër (4) muajsh, bazuar në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështjet kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe të parandalohet mbajtja në gjendje pasigurie për një periudhë të gjatë e palëve dhe personave të tjerë të përfshirë në procesin gjyqësor (shih *mutatis mutandis* rastin e GJEDNJ-së, *parashtrues Sabri Güneş*, Aktgjykim i 29 qershorit 2012, paragrafi 40 dhe referencat e përmendura aty; dhe Rastin e Gjykatës Kushtetuese, *parashtrues Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 marsit 2014, paragrafi 24).
108. Nga sa më sipër, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesve të kërkesës në lidhje me këtë pretendim duhet të refuzohet si e paafatshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.

Përfundim

109. Si përfundim, në lidhje me pretendimin e parë të parashtruesve të kërkesës që ndërlidhet me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për mosarsyetim të vendimit, Gjykata në pajtim rregullin 39 (2) të Rregullores së punës konstatoi se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.
110. Lidhur me pretendimin e parashtruesve se nuk është marrë parasysh nga gjykatat e rregullta kërkesa e parashtruesve për ekspertizë financiare të ngritur nga parashtruesit e kërkesës, Gjykata konstaton se ky pretendim i parashtruesve të kërkesës bie në pretendime “*të pambështetura apo paarsyetuara*”, dhe rrjedhimisht, të papranueshme si qartazi të pabazuara në bazë kushtetuese.
111. Lidhur me pretendimin e parashtruesve për veprimet kundërligjore dhe kundër kushtetuese të Përmbartuesit Privat, Gjykata të njëjtin e refuzon si të paafatshëm në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 9 dhjetor 2021, me shumicë,


VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Remzije Istrefi- Peci


Gresa Caka-Nimani

